

PAUL CELAN
LULËKUQJA DHE KUJTIMI

BOTIMET TOENA

Ky libër botohet me mbështetjen
e Ministrisë së Kulturës.



&

“Botimi i kësaj vepre u mbështet financiarisht nga TRADUKI, një rrjet letrar ku bëjnë pjesë Ministria Federale për Evropë, Integrim dhe Punë të Jashtme e Republikës së Austrisë, Ministria e Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë, Fondacioni zviceran ‘Pro Helvetia’, ‘KulturKontakt Austria’ (ngarkuar nga Zyra e Kancelarit Federal të Republikës së Austrisë), Instituti ‘Goethe’, Agjencia Sllovene e Librit ‘JAK’, Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë, Departamenti i Kulturës i Qeverisë së Principatës së Lihtenshtajnit, Fondacioni Kulturor i Lihtenshtajnit, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Kulturës dhe e Informimit e Republikës së Serbisë, Ministria e Kulturës e Republikës së Rumanisë, Ministria e Kulturës e Malit të Zi dhe Fondacioni ‘S. Fischer’”.

traduki^T

PAUL CELAN

LULËKUQJA DHE KUJTIMI

Përktheu nga origjinali gjermanisht
Anrila Spahija (Ana Kove)

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2018

Autori: Paul Celan
Titulli në origjinal: Mohn und Gedächtnis
Botoi në gjermanisht: Deutsche Verlags-Anstalt a division of
Verlagsgruppe Random House GmbH, Munchen, Germany

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Korrektore letrare: Arlinda Rrushji
Përkujdesja grafike: Elida Stafa
Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-235-93-0

© *e përkthimit:* S. Fischer Foundation me porosi të “TRADUKI”-t.
© 1952, Deutsche Verlags-Anstalt, Munchen
a division of Verlagsgruppe Random House GmbH,
Munchen, Germany
© *në shqip* Botimet Toena, 2018

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi
me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me
shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë
Tel.: + 355 4 22 40 116
E-mail: redaksia@toena.com.al
botimet.toena@gmail.com
www.toena.com.al

RËRË NGA URNAT

NJË KËNGË NË SHKRETËTIRË

Një kurorë qe thurur nga gjethnajë e zezë në Akra:
aty tërhoqa kalin e zi dhe vdekjen thera me shpatë.
Nga lëvore drurësh piva hirin e burimeve në Akra
dhe u nisa me vështrim të kapitur rrënojave të qiellit.

Të vdekur janë engjëjt dhe i verbër Zoti në Akra,
askush nga sa gjetën paqe këtu s'më mbron dot në gjumë.
Shkërmoqur në copëza ish hëna, gonxhja e Akras:
bulojnë e shndërrohen në gjemba duart me unaza ndryshku.

Gjer përtokë i përkulem puthjes, kur ato luten në Akra...
Oh, e tmerrshme parzmorja e natës, kur gjaku kullon
përmes hallkash!
Dhe i buzëqeshur isha unë, vëllai, Kerubin i hekurt i Akras.
Sa herë ia them emrin, sërish e ndiej përzhitjen në faqe.

NETËVE trupi yt nxihet nga ethet e Zotit:
Goja ime valëvit pishtarë mbi faqet e tua.
Mos ki dert, ata asnjë ninullë s'i këndojnë.
Me dorën plot borë unë erdha drejt teje,

i papërshkrueshëm, si bluja e syve tu
në një rrotullim akrepash. (Hën' e një kohe
qe më e rrumbullt).
Në çadrën e zbrazët ngashërehet magjia,
e nxirë shtambë e ëndrrës – ç'bëhet kështu?

Ndërmend: kjo gjethe e zezë varur mbi shtog -
shenjë e bukur vetëm për kupën e gjakut.

MË KOT ti vizaton zemrat në dritare:
sundimtar i heshtjes
shënjon ushtarët poshtë në oborrin e kështjellës.
Flamurin e tij ngre në pemë – një gjethe, që blu e bën
vjeshta;
kallinjtë e trishtimit hapërdan ndër turma dhe lulet
e kohës;
me zogjtë përmbi krye shkon të ngulë shpatat.

Më kot vizaton ti zemrat në dritare: një Zot endet
mes turmash,
mbështjellë me mantelin që një natë të ra nga supet
nëpër shkallë,
kur kështjella gjendej në flakë, kur ti flisje si njerëzit:
e dashur...
Ai s'e njeh mantelin, s'e ndjell dot yllin,
ndjek veç atë gjethe që dridhet para tij.
"O Kalli", i kumbon ndër veshë, "o lule e kohës".

MARIANA

Nuk është prej jargavani floku yt, fytyra jote qelq pasqyre.
Reja tërhiqet nga njëri sy drejt tjetrit, si Sodoma drejt
Babelit:
kullën shkërmoq si gjethen dhe vlon rreth shtjellës
së squfurt.

Pastaj një vetëtimë të shkrepin rreth gojës – hon
me copëra të thyera violine.
Me dhëmbë prej bore dikush drejton harkun:
Oh, sa bukur kumbon kallamishtja!

E dashur, ti je kallamishtja dhe ne të gjithë jemi shiu;
si verë e rrallë trupi yt, dhe ne tërë etje pimë të dhjetë;
një varkë në drithë zemra jote, që e shtyjmë drejt natës:
një shtambëz e kaltër, ti lehtë kërcen mbi ne,
dhe ne flemë...

Të nginjur ne, kur përpara tendës avitet skuadra,
të ngremë ty drejt varrit.
Mbi epitafin e kohës tingëllon vetëm monedha e ngurtë
e ëndrrave.

DRITË QIRIU

Murgj me gishtërinj leshtorë shfletojnë librin: shtator.
Jansoni godet me dëborë mbi farën e mbirë.
Një gjerdan duarsh të jep pylli dhe ti çapitesh e vdekur
mbi litar.

Blu i errët bëhet në çast floku yt, kur unë them fjalë
dashurie.

Guaskave të detit dhe një puplajë resh iu flas,
ndërsa një varkë mugullon nën shi.
Një mëz hamshor gjuan mbi gishtat shfletues -
porta hapet fshehtas, unë këndoj:
Si vallë jetuam ne këtu?

DORËN mbushur plot me orë – kështu erdhe tek unë,
e të thashë:

Floku yt s'është bojëkaf'.

Ndaj lehtas e hodhe mbi faqet e dhimbjes, e mandej
floku u bë më i rëndë se unë...

Ata e marrin turravrap dhe e ngarkojnë në anije,
për shitje e nxjerrin në tregjet e qejfit.

Ti buzëqesh për mua nga thellësia, ndërsa unë lotoj
për ty nga çanak i papeshë.

Dhe qaj: Floku yt s'është bojëkaf', ata të dendin me ujët
e liqenit, kurse ti u jep kaçurrelat...

Më pëshpërit: Ata tani po e mbushin botën me mua,
por unë mbetem për ty si udhë e zbrazët në zemër!

Më thua: Vendose gjethen e viteve pranë vetes –
është koha të vish të më puthësh!

E errët është gjethja e viteve, por jo floku yt.

MESNATË

Mesnatë. Me kamën e ëndrrës ngërthyer në përshkënditjet
e syve.

Mos bëzaj prej dhimbjes: retë flatrojnë si shami.

Një qilim mëndafshi rri ndehur midis nesh, vallëzues
prej territ në terr.

Flaut' i zi gdhendur nga dru i gjallë grish kërcimtaren.

Gishtërinj të endur me shkullmë deti na ngulen në sy:

E kush ka dëshirë të qajë?

Askush. Ndaj vorbullon lumnueshëm e zhurmon timpan
i zjarrtë.

Rrathë të hedhur prej tij në teh të thikës mbërthejmë.

Vallë po na marton ai? Me cifla të thyera tingëlluese,

dhe unë e di ç'ndodh:

Ty s'të del shpirti

në vdekje ngjyrë mavi!

FLOKU YT PËRMBI DET

Valëvitet floku yt përmbi det bashkë me dëllinjën e artë.
Bashkë me të, kur të zbardhet, do ta ngjyros në gurrkali
ngjyrën e qytetit, ku së fundi zvarrë më tërhoqën

drejt Jugut...

më lidhën dhe ngërthyen në secilin litar nga një velë
mbi mua pështynë me gojë të mjegullta dhe kënduan:
“Oh, eja mbi det!”

Dhe veten e përfytyrova si një barkë që lëkundej,
vetë e fryva flladin në det, u zhduka, ndërsa ata flinin.
Më duhet t'i ngjyrosja me të kuq krelat e tua, dhe pse i doja
ashtu: gurrkali.

Oh, sytë e qytetit, ku u gremisa dhe rashë përtokë në Jug!
Bashkë me dëllinjën e artë valëzon floku yt përmbi det.

PLEP I EGËR, gjethja jote zbardhon në terr.
Floku i nënës sime s'u zbardh dot.

Luleradhiqe, ja, kaq e gjelbër është Ukraina.
Nëna ime flokëverdhë s'u kthye dot në shtëpi.

O re e shiut, ti rri buzë burimesh?
E paqta nëna ime qan për të gjithë.

O yll i rrumbullt, ti mbështjell fjongon e artë.
Zemër e nënës sime ishte plagë prej plumbi.

O derë e lisit, kush të hap ty tani?
E ëmbla nëna ime s'vjen më kurrë.

BARISHTET E KËQJJA

Zog shtegtar, qëmoti është kaptuar fluturimthi ky mur,
dega mbi zemër tash zbardh, dhe deti mbi ne,
kodër' e thellësisë gjethnajë e qarkuar nga yje mesdite -
një blerim i pahelmët si i syrit, që ajo gëlltiti në vdekje...

Ne rrëmonim për të nxjerrë duart nga përroi thithës:
uji i vendit, me terr sa s' shihet as gishti në sy.
Ti këndon një këngë, ndërsa ne thurim rrjetën në mjegull:
me gjasë xhelati do të vijë dhe sërish brenda nesh
do dridhet zemra;
me gjasë kulla sërish do shembet përmbi ne
dhe një trekëmbësh do lartohet ulëritës;
me gjasë mjekra do na thyhet dhe floku i saj i verdhë
do përskuqet...

Dega mbi zemër është zbardhur, dhe deti përmbi ne.

E FSHEHTA E FIEREVE

Në kubenë e shpatave hija këqyr zemrën gjetheblertë.
Vezullorë janë tehet: e kush s'ngurroi në vdekje
të dilte para pasqyrës?
Këtu gostitet me kupa dhimbja e gjallë:
Terri përhapet si lumnajë, eh, dhe pihet si të mos ishte ujë,
një luledele pyetet për dashurinë e ndaluar,
për më të zezat shilte të kampit, për më të rëndin flok...

Vetëm këtu të ngjeth mishtë feksja e metalit,
një send që vizllon si të ishte shpatë.
Ne zbrazim kupën nëpër gosti pasqyrash:
dy copash plasat njëra, atje ku jeshil jemi, si gjethet!

RËRË NGA URNAT

Myk jeshil është shtëpia e harresës.
Para shkundullimës së çdo porte, mavi bëhet bardi yt
kryeprerë.
Ai t'i godet me daullen prej myshku qimet e hidhura
të pubisit;
me gisht të qelbëzuar ta vizaton vetullën në rërë.
Më të gjatë e bën nga ç'ishte, dhe të kuqtë e buzëve të tua.
Ti mbush këtu urnat dhe zemrën tënde ushqen.

FLAMUR I FUNDIT

Kjo shtazë ngjyrë uji është pre e gjuetisë në krahina
të muzgëta.
Lidhe një maskë para sysh dhe qerpikët ngjyrosi jeshil.
Një tas me bollgur të ndenjur shërbehet mbi tavolinë
abanozi:
nga pranvera në pranverë këtu shkumëzon vera,
kaq i shkurtër është viti,
kaq të kripur e ka çmimin ky gjuajtës – trëndafil largësie:
mjekra jote e copëtuar, flamur i ndenjur në trung.

Retë dhe të lehurat! Ato kalërojnë marrëzinë ndër fiere.
Drejt dritës së rreme dhe frymës i hedhin rrjetat
si peshkatarët!
Një litar mbështjellin rreth kurorës dhe ftojnë për vallëzim.
Brirët lajnë në burim – dhe mësojnë joshjen e zërit.

A është i trashë ky mantel që ke zgjedhur,
aq sa të mbështjellë vezullimin?
Ata përvidhen si gjumi rreth trungjeve, sikur po të falin
ëndrrën.
Zemrat u hidhen përpjetë si toptha të myshkët çmendurie:
o shtjellë e leshtë ngjyrë uji, flamuri ynë përmbi kullë!

NJË kërcëllimë këpucësh hekuri dëgjohet në pemë
të qershisë.
Prej helmetash shkumëzon për ty vera. Qyqja e zezë
vizaton me kthetra portretin e saj në portat e qiellit.

Kryezbuluar ngrihet nga gjethnaja kalorësi.
Si mburojë mban të qeshurën tënde të vagullt,
gozhduar në peshqirin e armikut zbrujtur me djersë.
Atij i qe premtuar kopshti i ëndrrave,
ndaj shtizën gati mban, ndërsa trëndafilat thahen...

Zbathur vjen përmes ajrit që kaq shumë ngjan me ty:
këpucët e hekurta mbërthyer në duart e brishta,
betejën dhe verën kalon duke fjetur.
Gjak dikon për të qershia.

GOSTIA

E zbrazur nga kupat është hëna mbi hatullat e larta
të joshjes.
Pragu lëruar dhëmbësh, ngopur tërbim i parabehjes
së agut:
myshku na godet prej së larti, ata para mullinjve ndodhen
këtu,
të gjejnë te ne drithin e butë për rrotën që na bluan
ngadalë...

Nën qiellin e helmuar kallinj të tjerë janë irnosur,
ndryshe rikrijohet ëndrra prej këtu, ku ne rrokullisemi
si zaret rreth qejfit;
prej këtu, ku shkëmbehet në terr harresa me habinë,
ku gjithçka vlen veç një orë, që në ekstazë paditet prej nesh,
në ujin e panginjur të dritareve, hedhur në zemrat
e ndritshme
shpërthejnë mbi rrugët e njerëzve retë drejt lavdisë!

Kështu mbështilleni me mantel e hidheni me mua
mbi tavolina:
sa ndryshim ka të jesh i përgjumur, apo i zgjuar në mes
të kupës?
Kujt t'ia pimë ëndrrat me fund, veçse rrotës që na bluan
ngadalë?

SY I ZI NË SHTATOR

Kube e gurtë. Burime të harlisura,
kaçurrelat e dhimbjes qark fytyrës së tokës,
mollë e dehur, nxirë nga hukama e një thënieje mëkatore:
bukuri përballë pasqyrës,
që grish në terrin e reflektimit të nesërm.

Për herë të dytë lulëzon gështenja:
feksje e një flake të vagullt shprese
në rikthimin e shpejtë të Orionit:
që prej së larti i rrëfen
zjarrin e ndjenjës vezulluese
mikut të verbër të qiellit.

I pambrojtur në portat e ëndrrës
lufton një sy i vetmuar.
Mjaft të dijë ç'ndodh çdo ditë:
në dritaren e lindjes
i shfaqet gjatë natës silueta gjatoshe
e ndjenjës shtegtare.

Në lëng të syrit të saj ti zhyt shpatën tënde.

GUR NGA DETI

Zemër e bardhë e botës sonë ne humbëm sot pa mëshirë
orën e të verdhës gjethe misri:
një lëmsh i rrumbullt na rrëshqiti lehtë prej duarsh.
E s'na mbet veç të endnim një tjetër, me leshin e kuq
të gjumit në varrin prej rëre të ëndrrës:
një zemër s'rreh më, por flokët e rrashtës së gurit
nga thellësia
zbukurojnë vagullt ballin e tij, që mediton
mbi guaska deti dhe valë.

Me gjasë, nga portë e çdo qyteti atë e ngre n'ajri
një vullnet atësor,
syri i tij prej lindjes çelet përmbi shtëpinë ku gjendemi
shtrirë,
të zinjte e detit ka rreth gojës dhe tulipanët e Holandës
nëpër flokë.
Ata mbajnë heshtat përpara, siç mbanim ne ëndrrat.
Kështu na vërtit zemra e bardhë e botës sonë.
Kështu i thuret atij kreshta rreth kokës: me lesh të rrallë
në të bukurin vend të zemrës.
O puls, që rreh dhe venitesh.

Në orën e mbrame valëviten perdet.